



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



L I C E N C Ě E S H Ě R B I M I T

E LËSHUAR PËR:

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT “PRISHTINA”
SH.A.PRISHTINË

maj 2016

LICENCË E SHËRBIMIT

1. Përkufizimet dhe Interpretimet

- 1.1. Në këtë licencë të shërbimit, fjalët dhe shprehjet e shkruara në fontin *italik*, do ta kenë kuptimin ashtu siç është përkufizuar në shtojcën 1 të kësaj licence të shërbimit, ose në Rregullën për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimit dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë, të datës Qershor 2014 (në tekstin e mëtutjeshëm: Rregulla - R01).
- 1.2. Interpretimi i kësaj licence të shërbimit do të bëhet në pajtim me rregullat vijuese:
 - a) Fjalët që paraqesin një rëndësi do të përfshijnë edhe gjininë tjetër;
 - b) Fjalët që paraqesin njëjës do të përfshijnë shumësin dhe anasjelltas;
 - c) Referenca në pjesë, klauzola, apo shtojca nënkupton pjesët, klauzolat apo shtojcat e kësaj licence të shërbimit;
 - d) Titujt janë vendosur për përdorim më të përshtatshëm dhe nuk kanë ndikim në interpretimin e kësaj licence të shërbimit;
 - e) Referencat në një ligj, rregullore të nxjerrë nga Autoriteti, udhëzim administrativ, urdhëresë tarifore, kartë të konsumatorëve, certifikatë të licencës së shërbimit, apo ndonjë dokument tjetër, iu referohen atij ligji, rregullore, udhëzimi administrativ, urdhërese tarifore, karte të konsumatorëve apo dokumenti tjetër bashkë me ndryshimet, plotësimet, apo zëvendësimet që iu bëhen atyre kohë pas kohe.

2. Lëshimi i Licencës së Shërbimit

Autoriteti e lëshon këtë licencë të shërbimit për të *Licencuarin* në pajtim me *Ligjin* për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit Nr.05/L-042 për dhe R01.

3. Afati i Licencës së Shërbimit

Afati i vlefshmërisë së kësaj licence të shërbimit fillon në datën e lëshimit dhe vazhdon deri në:

- a) datën e revokimit nga *Autoriteti*, në pajtim me *Ligjin Nr. 05/L-042*;
- b) datën 10.09.2018 - vlefshmërinë e Vendimeve të MMPH për shfrytëzimin e burimeve ujore

4. Zona e Shërbimit

- 4.1. *I Licencuari* do të ofrojë *shërbimet* në tërë zonën e shërbimit në pajtim me kushtet dhe dispozitat e përcaktuara në këtë licencë të shërbimit.

- 4.2. *Zona e shërbimit* në të cilën i Licencuari është i autorizuar të ofrojë *shërbimet* përfshijnë komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Podujevë, Lipjan, Glogovac, Shtime dhe Graçanicë.
- 4.3. I licencuari obligohet të pranoj rristurimin, në kuptim të konsolidimit të zonës së shërbimit.
- 4.4. I licencuari obligohet të njoftojë Autoritetin për ndryshimin (zgjerimin eventual) e zonës së shërbimit me rastin e marrjes nën menaxhim të sistemeve rurale me burime të vecanta.

5. Obligimet e të Licencuarit

I Licencuari është i obliguar që gjatë tërë afatit të vlefshmërisë së licencës së shërbimit të jetë në pajtim me:

- a) *Ligjin* për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit Nr.05/L-042;
- b) Kërkesat e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës;
- c) Udhëzimin Administrativ nr.16/2012 për Cilësinë e ujit për konsum nga njeriu;
- d) Rregulloret e nxjerra nga *Autoriteti* në pajtim me Nenin 47 të Ligjit Nr 05/L-042;
- e) Vendimet e *Autoritetit* të marra në pajtim me Ligjin Nr.05/L-042;
- f) *Këtë licencë të shërbimit*;
- g) *Kartën e Konsumatorëve*;
- h) *Kontratën e Shërbimit*;
- i) *Marrëveshjet e Shërbimit* me komunat;
- j) Ligjet e aplikueshme mjedisore;
- k) Licencat, lejet, udhëzimet dhe kërkesat tjera nga institucionet përkatëse në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

6. Tarifat dhe Taksat

- 6.1 I Licencuari është i obligueshëm të i paguajë *Autoritetit* taksën vjetore të licencimit në pajtim me nenin 14 të *Ligjit* Nr.05/L-042.
- 6.2. I Licencuari është i obliguar gjatë tërë kohës së vlefshmërisë së licencës së shërbimit të mirëmbajë kapacitetet financiare, teknike, operative, dhe menaxheriale të nevojshme për ofrimin e *shërbimeve* në nivel të standardeve minimale të shërbimit në pajtim me *Ligjin* Nr.05/L-042 dhe Rregulloret e nxjerra nga *Autoriteti*.
- 6.3. Kërkohet angazhim i menjëhershëm i menaxhmentit të të licencuarit, me qëllim të ngritjes së efikasitetit të përgjithshëm . Afarizmi i të Licencuarit do të monitorohet nga Autoriteti.

7. Kërkesat Raportuese

I Licencuari është i obligueshëm të përgatisë dhe të dorëzojë tek *Autoritetit* raporte në formën dhe intervalet e përcaktuara në Rregulloret e nxjerra nga *Autoritetit* të plotësuara dhe të ndryshuara kohë pas kohe.

8. Përtëritja e Licencës së Shërbimit:

Kjo licencë e shërbimit mund të përtëritet nga *Autoritetit* me kërkesë të të *Licencuarit* në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-042 dhe Rregullën R01.

9. Transferimi i Licencës së Shërbimit

Kjo licencë e shërbimit nuk mund të i transferohet ndonjë pale të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim nga *Autoritetit* në pajtim me Rregullën R01.

10. Ndryshimi, Plotësimi dhe Zëvendësimi i Licencës së Shërbimit

Licenca e shërbimit mund të ndryshohet, plotësohet dhe zëvendësohet nga *Autoritetit* në pajtim me *Ligjin* Nr.05/L-042 dhe Rregullën R01.

11. Masat Administrative

- 11.1. Në rast se *i Licencuari* bën shkelje të *Ligjit* Nr.05/L-042, Rregulloreve të nxjerra nga *Autoritetit* apo kushteve të kësaj licence të shërbimit, *Autoritetit* mund të shqiptojë masa sanksionuese administrative në pajtim me nenin 39 të *Ligjit* Nr.05/L-042.
- 11.2. *Autoritetit* gjatë kohëzgjatje së licencës së shërbimit kohë pas kohe do të inspektojë zbatimin e kësaj licence të shërbimit.

12. Të Ndryshme

- 12.1. Në rast të ndonjë mospërputhje në mes versioneve gjuhësore të kësaj licence të shërbimit, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- 12.2. Nëse dispozitat dhe kushtet e kësaj licence të shërbimit janë në papajtueshmëri me dispozitat dhe kushtet e Kontratës për Shërbime, Kartës së Konsumatorëve, Marrëveshjes për Shërbime, atëherë dispozitat dhe kushtet e parapara me këtë licencë të shërbimit do të kenë përparësi.

- 12.3. Çertifikata e licencës së shërbimit dhe Deklarata për pranimin e përgjegjësisë janë pjesë përbërëse e kësaj licence të shërbimit.
- 12.4. Nëse ndonjë dispozitë e kësaj licence të shërbimit është përcaktuar nga autoriteti kompetent si i pavlefshëm (zbrazët) ose i pazbatueshëm për çfarëdo arsye, atëherë ajo dispozitë do të largohet dhe dispozitat e mbetura do ta vazhdojnë të jenë në fuqi dhe me efekt të plotë.
- 12.5. Asnjë heqje dorë nga ndonjë prej dispozitave apo kushteve të kësaj licence të shërbimit nga ana e *Autoritetit* nuk do të ketë efekt nëse ato nuk i ofrohen të *Licencuarit* në formë të shkruar. Dështimi për të zbatuar cilëndo dispozitë apo kusht të kësaj licence të shërbimit nga ana e *Autoritetit* nuk përbën heqje dorë nga ajo dispozitë apo kusht dhe nuk do të paragjykojë të drejtën e *Autoritetit* për të zbatuar ato më vonë.

Shtojca 1: Përkufizimet

Në këtë licencë të shërbimit janë të aplikueshme përkufizimet si vijon:

Autoritet nënkupton Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit;

Çertifikatë e Licencës së Shërbimit nënkupton çertifikatën aktuale të licencës së shërbimit të lëshuar nga *Autoritetit* e cila është pjesë përbërëse e licencës së shërbimit;

I Licencuari nënkupton Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" Sh.A.-Prishtinë;

Karta e Konsumatorëve nënkupton dokumentin që u jepet konsumatorëve nga Ofruesi I shërbimit, e cila është e bazuar në rregulloret e lëshuara nga Autoriteti, i cili në mënyrë të qartë thekson të drejtat dhe obligimet e ndërsjella mes konsumatorit dhe ofruesit të shërbimit, lidhur me shërbimet e ofruara;

Komunat nënkupton komunat të cilat janë themeluar në pajtim me Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave;

Konsumator nënkupton çdo person që ka lidhë kontratë të shërbimit me të Licencuarin ose që merr shërbime nga i Licencuar/ofruesi i shërbimit;

Kontratë e Shërbimit nënkupton kontratën standarde e cila lidhet mes ofruesit të shërbimeve dhe konsumatorit, i cili rregullon ofrimin e shërbimeve, të drejtat dhe obligimet e palve kontraktuese;

Ligji Nr.05/L-042 nënkupton *Ligjin për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit*;

Marrëveshje e Shërbimit nënkupton marrëveshjen e lidhur mes Komunës dhe të të Licencuarit nën mbikëqyrjen e Autoritetit në të cilën janë përcaktuar të drejtat dhe obligimet e të dy palëve në lidhje me ofrimin e shërbimeve;

Ofruesi i Shërbimit nënkupton çdo ofrues i shërbimit të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizues të ujit me shumicë;

Shërbimet nënkupton:

- a) Shërbimet e Ujësjellësit marrja, përpunimi dhe shpërndarja e ujit për konsum njerëzor si dhe operimi i rrjetit dhe objekteve për atë qëllim; dhe
- b) Shërbimet e ujërave të ndotura grumbullimi, bartja, trajtimi dhe shkarkimi i ujërave të ndotura të përdorura nga shfrytëzuesit shtëpiak, komercial, industrial dhe publik;

Tarifat e Shërbimit nënkupton vlerat, ngarkesat apo tarifatat fikse të ofruesve të shërbimit me cilën ofruesi i shërbimeve e ngarkon konsumatorin në lidhje me ofrimin e shërbimeve;